



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:084438

Datë: 26.04.2021

Numri i dokumentit: 01729018

P.nr.324/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Ahmet Rexhaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lindmire Begolli, në çështjen penale ndaj të akuzuarve: M. I. nga, rruga “.....” dhe I. Sh. nga fshati, Komuna për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprë penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme PP/II.nr.597/2019 të datës 19.03.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurorit të shtetit Dorina Juniku, të akuzuarve M. I. dhe I. Sh., e në mungesë të palës së dëmtuar Kuvendi Komunal në Pejë-Drejtorati i Inspektionit-Sektori i Inspektionit të Ndërtimtarisë Pejë, me datë 12.04.2021 mori dhe shpalli si dhe me datë 20.04.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari M. I. i lindur me datë në Pejë, tani me banim në, rruga “.....” pa nr., i biri i D. dhe i nënës D. e gjinisë A., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion autongjyrosës, i martuar, baba i katër fëmijëve, i gjendjes së memse ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

2. I akuzuari I. Sh., i lindur me datë në fshatin, Komuna, ku edhe tani jeton, i biri i M. dhe i nënës A. e gjinisë B., ka të kryer shkollën e mesme, mjeshtër i ndërtimit, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

Për shkak se:

Të akuzuarit M. I. dhe I. Sh.

Me datën 02.03.2019, në kohë të pa caktuar, rruga e “.....” pa nr. në, në bashkëveprim kanë hequr vulën zyrtare së bashku me shiritin, në atë mënyrë që me datë 26.02.2019 Inspektioni Komunal për ndërtim, gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në lidhje me mbikëqyrjen e ndërtimeve, të pandehurit M. I. i kishte bërë ndërprerjen e punëve ndërtimore të

objektit, duke vendosur shpirtin rreth objektit si dhe shenjën zyrtare, edhe përkundër asaj që ishte paralajmëruar që të ndërprehet puna me rastin e vendosjes së shiritit, të pandehurit kanë hequr vulën zyrtare-shiritin dhe kanë vazhduar me ndërtim.

-Me çka në bashkëveprim kanë kryer vepër penale, heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 7,41,42,43,46,73, të KPK-së, nenit 414 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarve M. I. dhe I. Sh. iu shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të akuzuarit M. I. i përcaktohet dënimi me gjobë në shumë prej 300€ (treqind euro), e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari M. I. që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€, si dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ashtu që të akuzuarit I. Sh. i përcaktohet dënimi me gjobë në shumë prej 300€ (treqind euro), e të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari I. Sh. që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€, si dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar Kuvendi Komunal në Pejë-Drejtorati i Inspektionit-Sektorit i Inspektionit të Ndërtimitarisë Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.597/2019 të datës 19.03.2019, ndaj të akuzuarve: M. I. nga, rruga “.....” dhe I. Sh. nga fshati, Komuna për shkak se në bashkëveprim kanë kryer vepër penale heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/II.nr.597/2019 të datës 19.03.2019, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën

dhe të akuzuarve iu ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarit për rendësin dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe i akuzuari M. I. ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha përpirësit dhe benefitet për pranim të fajësisë dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe premtion se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të tilla apo të ngjashme.

I akuzuari I. Sh. ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha përpirësit dhe benefitet për pranim të fajësisë dhe se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, paraprakisht ka pasur dilema sa i përket kualifikimit të veprës, por nga sqarimi i gjyqtarit të çështjes çdo gjë është e qartë, është e vërtetë se ditën kritike punët ndërtimore janë zhvilluar në objektin e këtu të akuzuarit M. I. për çka ndoshta nuk ka qenë i vëmendshëm dhe nuk i ka kuptuar pasojat që mund të rrjedhin nga puna e tij, kërkon falje e ndinë veten të penduar dhe premtion se në të ardhmen nuk do ti përsëris veprimet e tilla apo të ngjashme.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve për veprën penale e cila iu vihet në barrë, ashtu që nga Gjykata kërkon që përcaktimi dhe lloji i dënimit pranimin e fajësisë të vlerëson si rrethanë lehtësuese.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarve, pasi që ata e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti i oficerit B. L. e datës 31.12.2018, vendimi i Drejtorisë së Inspeksionit e datës 22.11.2018, vendimi i Drejtoratit të Inspeksionit e datës 04.12.2018, procesverbalin nga Divizioni për Inspektimit të Ndërtimeve në Pejë e datës 26.02.2019, aktvendim për ndalim e personit të arrestuar e datës 02.03.2019, deklarata e ankuesit M. B. e datës 02.03.2019, deklarata e të pandehurit M. I. e datës 07.03.2019, deklarata e të pandehurit I. Sh. e datës 02.03.2019, deklarata e të pandehurit L. Sh. e datës 02.03.2019, aktvendimi mbi lirimin e personit të arrestuar e datës 02.03.2019, fotodokumentacioni, gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha elementet e veprave penale të përshkruara si në dispozitivin një dhe dy të këtij aktgjykimi e për të cilin janë shpallur fajtor.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e kanë pranuar fajësinë qysh në fillim, patën sjellje korrekte në shqyrtim fillestar, janë penduar, për gjykatën nuk ka të dhëna se të njëjtit kanë ra ndesh me ligjin më parë, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarit e lartcekur gjykata nuk ka gjete asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë

penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimin e që është pengimi i të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KRPK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, i obligoi të akuzuarit e lartcekur që secili veç e veç ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit i obligoi të akuzuarit që secili veç e veç ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Konform nenit 463 të KPPK-së, gjykata e udhëzoi palën e dëmtuar Kuvendi Komunal në Pejë-Drejtorati i Inspektionit-Sektori i Inspektionit të Ndërtimtarisë Pejë për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm,
P.nr.324/19, me datë 20.04.2021.**

Sekretare juridike
Lindmire Begolli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ahmet Rexhaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.